

**UDHËZIM**  
**Nr. 10, datë 20.4.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS, LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE ONLINE TË SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR**

*(Ndryshuar me udhëzimin nr. 11, datë 20.5.2022)*

*(1 përditësuar)*

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015, “Për shërbimin gjeologjik shqiptar”, të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, si dhe në përputhje me urdhrin e Kryeministrit nr. 153 prot., datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *on-line* nga data 1.1.2020”,

**UDHËZOJ:**

1. Shërbimet që jepen *online*, nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë:

- a) oponenta për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale;
- b) dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.;
- c) studime në fushën e gjeoshkencës;
- ç) harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë.

2. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, bëhet vetëm nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* (në vijim portali *e-Albania*), nga qytetarët, bizneset apo institucionet.

3. Kostot për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, janë specifike sipas dokumentit gjeologjik të kërkuar, bazuar në tarifat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët me nr. 5105/5, datë 19.8.2021 dhe 11557/3, datë 31.8.2021, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”.

4. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimit për “Oponenta për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale”, duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë, i cili ngarkohet nga kërkuuesi në portalin *e-Albania*:

- a) studimi dhe materiali grafik që kërkohet t’i bëhet oponenta sipas rastit;
- b) harta dhe material tjetër grafik shoqërues i studimit.

5. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Oponenta për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale”, ndiqet procedura si më poshtë:

- a) kërkuuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;
- b) pas zgjedhjes së shërbimit “Oponenta për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale”, kërkuuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

*c. Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara, bëhet konfirmimi*

*ç. Kërkuuesi brenda 30 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin e-Albania, për shërbimin e kërkuar.*

6. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.”, nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

7. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.”, ndiqet procedura si më poshtë:

- a) kërkuksi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;
- b) pas zgjedhjes së shërbimit “Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.”, kërkuksi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;
- c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës;
- ç) kërkuksi brenda 5–10 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin *e-Albania*, për studimet pa llogaritje rezervash;
- d) kërkuksi brenda 20–30 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin *e-Albania*, për studimet me llogaritje rezervash.

8. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Studime në fushën e gjeoshkencës”, nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

9. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Studime në fushën e gjeoshkencës”, ndiqet procedura, si më poshtë:

- a) kërkuksi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;
- b) pas zgjedhjes së shërbimit “Studime në fushën e gjeoshkencës”, kërkuksi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;
- c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.
- ç) kërkuksi brenda 30–90 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin *e-Albania*, për shërbimin e kërkuar.

10. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë”, nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

11. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për “Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë”, ndiqet procedura si më poshtë:

- a) kërkuksi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;
- b) pas zgjedhjes së shërbimit “Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë”, kërkuksi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;
- c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.
- ç) kërkuksi brenda 5–10 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin *e-Albania*, për shërbimin e kërkuar.

12. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**Belinda Balluku**